



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDIM

Nr. 8, datë 29.5.2019

**PËR DISA ÇËSHTJE TË RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
SË KONFERENCËS SË KRYETARËVE, DATË 29.5.2019**

Në mbështetje të neneve 12, 26 dhe 27 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Miratohet me mirëkuptim Programi i Punës së Kuvendit për periudhën 3 qershor – 12 korrik 2019 me propozimet e bëra dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancën plenare të datës 30.5.2019.

II. Miratohet me mirëkuptim Kalendari 3-javor i Punimeve të Kuvendit për periudhën 3 – 21 qershor 2019, me ndryshimet e propozuara në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe i përcillet Kuvendit për njoftim në seancën plenare të datës 30.5.2019.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gramoz Ruçi

